



VisitTirana

Gazetë Mujore e Tiranës turistike, Shkurt 2017

Art, kulturë, muzikë, argëtim, aventurë e plot surpriza, për ata që e duan këtë qytet



Së shpejti: Konkursi #TiranaSpring

Hapim konkursin e dytë në mediat sociale me fotot më të bukura të Tiranës gjatë shpërthimit të luleve të pranverës. Ftojme bizneset të bëhen partnerë dhe sponsorë të këtij konkursi. Për fotot më të bukura do ketë çmime. Shihni konkursin e mëparshëm [#TiranaAutumn](#)

Shën Valentini në Tiranë



14 Shkurti është një ditë e zhurmshme për Tiranën, një tendencë që shqiptarët janë të etur për të ndjekur. Shumë të rinj e kanë shënuar këtë ditë në kalendarin e tyre, dhe në përgjithësi bëjnë plane ditë përpara.

Për të kuptuar historinë e festës dhe për të parë si e kanë festuar këtë festë në Tiranë, lexoni artikullin tonë.

Guidë shumëngjyreshe në Tiranë



Tirana është një qytet i njohur për ndërtesat shumëngjyreshe. Pamja e qytetit filloi të ndryshojë kur ish-kryetar i Bashkisë së Tiranës, Edi Rama i dha jetë me kontrastet e forta të ngjyrave. Të njëjtin trend po ndjek kryebashkiaku i ri. Ndërtesat shumëngjyreshe janë të shpërndara në të gjithë qytetin, por në guidën tonë, do t'ju tregojmë të preferuarat tona.

#VisitTirana

EVENTE

TEATER

Opera për tri grosh në Teatrin Kombëtar.

Komedia satirike e shkruajtur nga autori çek, Vaclav Havel, autor i veprave të njohura si "Metamorfoza" dhe "Teatri i Absurdit" u shfaq në Teatrin Kombëtar.

"Zgjohu, vëlla arush", shfaqje për fëmijë në teatrin e metropolit.

Vepra e Janet Stanford, me regji nga Suela Xhonuzi u shfaq në Teatrin e Metropolit gjatë dy fundjavave të para të Shkurtit.

"Gjyshja ka ikur me cirkun"

shfaqja për fëmijë dhe të rinj në Qendrën Kulturore Tirana (Teatrin Metropol), e cila u ngjit në skenë fundjavën e parë të shkurtit dhe në datat 12, 18 shkurt.

"Lulet e dimrit" në Teatrin

Rikthimi i dashurisë për Teatrin



Teatri është shfaqja artistike më e preferuar për shqiptarët, dhe më e ndjekura. Kjo për vetë faktin se qytetarët mund të shohin në skenë aktorët e tyre të preferuar, por dhe sepse tematika e pjesëve teatrale është mjaft e lidhur me realitetin shqiptar. Shfaqja "Mendohu Xhakomino" ka thyer thyer rekordet e shikueshmërisë në Tiranë.

Teatri i Operas dhe Baletit zhvendoset në Kinostudio



Ministria e Kulturës, në një konferencë për shtyp deklaroi se Teatri i Operas dhe Baletit do të zhvendoset në godina të reja në Kinostudio, për tre vitet e ardhshme duke filluar nga data 20 Shkurt 2017. Projekti i rikonstruksionit të godinës aktuale që ndodhet në qendër të Tiranës do të kushtojë 1 miliard lekë, punimet parashikohen të përfundohen për një periudhë 3-vjeçare.

Metropol. Një shfaqje magjike baleti ku ndërthuret kërcimi me projektionin e dritave. "Lulet e dimrit" një shfaqje që zgjati 50 minuta.

"5 Djelmoshat" premiera më e re në Teatrin Kombëtar vjen e cila ka filluar në datat 24-25-26 Shkurt dhe vazhdon deri në javën e parë të Marsit. Kjo vepër trajton problematikën e 5 djelmoshave, në moshën 10-11 vjeçare dhe është një shkundje e fortë për gjithë shoqërinë.

Shfaqja Pasardhësi në Teatrin Kombëtar: Shfaqja Pasardhësi" e autorit Ismail Kadare dhe me regji nga Slobodan Unkovski u performua nga turpa e Teatrit Kombëtar të Kosovës, në Teatrin Kombëtar, në 28 Shkurt.

Aventurë në natyrë

Ecje në Bovillë. Ky udhëtim u

[Muaj protestash, sheshe te bllokuara....](#)



Gjatë këtij muaji në Tiranë ka patur disa protesta që kanë rënduar disi trafikun në Tiranë. Protesta e Opozitës ka vendosur një çadër në mes të Bulevardët Dëshmorët e Kombit, duke krijuar dhe probleme qarkullimi për turistët, gjithsesi çadra e protestës duket se është parë si atraksion. Punimet në Sheshin Skënderbej gjithashtu kanë hequr mundësinë e qarkullimit të turistëve në sheshin kryesor të Tiranës. Shpresojmë që sheshet të zhblllokohen pasi janë arteriet kryesore nga kalojnë turistët.

EVENTE MARS



- Festat e 7 dhe 8 Marsit, festime ndryshe në Tiranë (7-8 Mars)
 - Dita e Verës, nga festat unike për shqiptarët, që nuk e kanë vendet e tjera (14 mars)
 - Cup Song, një festival muzike në ritmin e gotave plastike në zemër të Tiranës (25 mars)
 - Çfarë të bësh në pranverë në Tiranë. (rekomandimet tona)
- Bialja e akuarelit, nga 12 Mars- 12 prill, për herë të parë në Tiranë

organizua nga Bashkia e Tiranës, në bashkëpunim me guidën e Albanian Mountain Team. Një udhëtim që ka si synim të promovojë bukuritë natyrore të zonave rurale të Tiranës.

Muzikë dhe Koncerte

[14 Shkurt, Muzika më e mire në rajon në disa nga baret më IN.](#) Në 14 shkurt Tirana gëloi nga festat në 14 nga baret më të njohura të kryeqytetit, ku performuan mbi 30 artistë, muzikantë e DJ të ardhur nga e gjithë Evropa **[Guitar Sounds Festival](#)** u zhvillua si një aktivitet që ka si synim përmirësimin e instrumentit të kitares në Shqipëri. Festivali u mbajt për 3 ditë ku u organizuan tre koncerte nga tre artistë.

[Shfaqje Cirku](#)

[Shfaqje në Cirkun Kombëtar:](#) Shfaqja e Cirkut "Një vit në një orë", është një shfaqje ku publiku do të zbulon punën dhe arritjet një-vjeçare të mjeshtrave dhe artistëve të Cirkut Kombëtar të përmbledhur artistikisht në 60 minuta.

Për më shumë artikuj unikë gjatë gjithë muajve klikoni në: <http://www.visit-tirana.com/sq/lajme>

Visit Tirana Rr. "Sami Frashëri", Nd.30, H.2, Ap.8, Tiranë

Tel: +355 4 5800419, Email: contact@visit-tirana.com; Web: www.visit-tirana.com

Follow us:   